

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Fatime Zehraja

(Paqja qoftë mbi të!)

në fjalët e Imam Khameneit

Tiranë, 2025

Titulli: **Fatime Zehraja në fjalët Imam Khameneit**

E përktheu: **Ma. Isra MERJA**

E redaktoi: **Jerida KULLA**

E korrektoi: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "Flladi" - Tiranë, 2025**

SIKUR BUKURIA TË ISHTE NJË PERSON, AJO DO TË ISHTE FATIMJA

Shembulli i Fatimes (*Paqja qoftë mbi të!*) është një thirrje e përjetshme për çdo besimtar që kërkon dritë në këtë botë të turbullt. Ajo na mëson se devotshmëria nuk është vetëm fjalë, por një udhëtim i vazhdueshëm drejt Allahut, një punë e heshtur që forcon zemrën dhe e çliron shpirtin nga dobësitë.

Çdo veprim i saj ishte një mesazh, çdo durim i saj ishte një dritë, çdo sakrificë e saj ishte një shkallë më afër të përjetshmes. Në fatkeqësitë që i ndodhën, ajo nuk u thye, por u ngrit më e fortë; në padrejtësitë që i bënë, ajo nuk shfaqti dobësi, por qëndroi me madhështinë e së vërtetës. Marrja e saj si udhëheqëse shpirtërore do të thotë të ndjekim rrugën e saj të pastërtisë, të moralit dhe të qëndrueshmërisë ndaj asaj që Allahu do.

Nëse ecim në gjurmët e saj, zemrat tona do të ndriçohen me atë dritë që Allahu ia dhuroi asaj që është “Zonja e grave të botëve”. Të jetojmë me kujtimin e Fatimes do të thotë të jetojmë me kujtimin e dritës; të pyesim veten në çdo hap: “A do të ishte e kënaqur Fatimja me këtë vepër,

me këtë sjellje, me këtë qëllim?” Kjo pyetje është çelësi që e mban zemrën të zgjuar dhe të lidhur me Allahun.

Është transmetuar se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Sikur bukuria të ishte një person, ajo do të ishte Fatimja; madje ajo është më e madhe. Vërtet, Fatimja, vajza ime, është më e mira në tokë për nga origjina, nderi dhe bujaria”.¹

Hadithi i bekuar që flet për Fatimen, bijën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është ndër dëshmitë më të larta të vlerësimit hyjnor dhe profetik për këtë figurë të jashtëzakonshme. Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: “Sikur bukuria të ishte një person, ajo do të ishte Fatimja; madje ajo është më e madhe...”, ai nuk flet për bukurinë sipërfaqësore, por për bukurinë që buron nga drita e shpirtit, pastërtia e zemrës dhe hijeshia e moralit.

Bukuria e Fatimes nuk ishte thjesht harmonia e pamjes, por ishte bukuria e një zemre që rrezatonte mëshirë, besim, modestinë më të lartë dhe devotshmëri të pakrahasueshme. Ajo ishte një bukuri që mbushte botën shpirtërore të njerëzve me dritë, ashtu si një yll që ndriçon udhën e humbësve në errësirë.

¹ “Sherhu Ihkakul Hakki”, vëll. 4, f. 502.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që nuk fliste nga vetja, por nga shpallja dhe udhëzimi hyjnor, e përshkruan Fatimen si “më të mirën në tokë për nga origjina, nderi dhe bujaria”. Origjina e saj ishte kulmi i pastërtisë, sepse ajo vinte nga shtëpia e profetësisë dhe ishte fryt i një drite hyjnore që përshkonte brezat deri te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Nderi i saj ishte nderi i një gruaje që Allahu e zgjodhi të jetë shembull për gratë e botëve. Ndërsa bujaria e saj ishte bujaria e një zemre që dha gjithçka për hir të Allahut, deri në pikën që i preferonte të tjerët, edhe atëherë kur vetë nuk kishte asgjë.

Fjalët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë një vulë e madhështisë së saj, sepse askush, përveç një zemre të përzgjedhur, nuk mund të marrë një përshkrim të tillë.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte pasqyrimi më i pastër i moralit profetik. Ajo mishëronte përlësinë në adhurim, drejtësinë në sjellje, butësinë në fjalë dhe guxim në mbrojtjen e së vërtetës. Bukuria e saj ishte bukuri vepre, bukuri sjelljeje dhe bukuri shpirti. Ajo ishte dita e qetësisë në jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte gëzimi i tij, sa herë hynte në shtëpi dhe ishte drita që Allahu vendosi mes qiellit dhe tokës përmes një gruaje të bekuar. Këtë madhështi, Profeti

Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e shprehu duke thënë se, nëse bukuria do të merrte formë njeriu, ajo do të ishte Fatimja, sepse zemra e saj ishte më e bukur se çdo formë fizike dhe më e shkëlqyer se çdo dritë e kësaj bote.

Ky hadith na mëson se madhështia e Fatimes nuk qëndron vetëm në lidhjen e saj familjare me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por në vlerat e saj, në dritën e sjelljes së saj dhe në përsosmërinë shpirtërore që e shndërroi atë në simbol të pastërtisë, devotshmërisë dhe forcës morale.

Ajo u bë shembull për nënat, për vajzat, për gratë e çdo kohe dhe një burim i pashtershëm frymëzimi për çdo besimtar që kërkon bukurinë e vërtetë, bukurinë që të afron me Allahun dhe të pastron shpirtin nga çdo errësi.

Ja si e përshkruante Imam Aliu Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Imam Aliu ka thënë për Fatime Zehranë: “*Sa herë e shihja atë, më ikte brenga që kisha në zemër. Pasha Allahun, kurrë nuk e kam zemëruar dhe kurrë nuk e kam bërë të qajë. As ajo nuk më ka zemëruar ndonjëherë dhe as më ka lënduar ndonjëherë*”.

Imam Aliu e përshkruante dashurinë për të, duke i thënë: “O bija e të Dërguarit të Allahut” dhe kurrë nuk e thirri me emër.

Ky përshkrim i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është thjesht një dëshmi bashkëshortore, por një dritare që na lejon të shohim madhështinë e karakterit të Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo ishte qetësia e zemrës së tij, strehimi ku shpirti i tij gjente pushim pas sfidave, luftërave dhe barrës së rëndë të drejtësisë.

Të jetosh pranë një gruaje që nuk të zemëron, që nuk të lëndon dhe që as vetë nuk preket nga inati apo zemërimi, është prova më e lartë e pastërtisë së saj shpirtërore.

E quante “O bija e të Dërguarit të Allahut” jo vetëm nga respekti, por, sepse shihte tek ajo të gjithë madhështinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo ishte drita që i lehtësonte dhimbjen, mirësia që i shuante trishtimin dhe shembulli më i pastër i një gruaje të përsosur, e cila e mbante shtëpinë e saj me dashuri, durim dhe devotshmëri.

Jeta e Fatimes (Paqja qoftë mbi të!) në adhurim

Adhurimi i Fatime Zehrasë (Paqja qoftë mbi të!) ishte një adhurim shembullor. Hasani el Basriu, i cili ishte një nga adhuresit dhe asketët e njohur në botën islame, thotë për Fatime Zehranë (Paqja qoftë mbi të!): “Vajza e Profetit e adhuronte Allahun dhe qëndronte në mihrabin e adhurimit, derisa i ënjteshin këmbët”.²

Imam Hasan El Muxhteba (Paqja qoftë mbi të!) thotë: “Në një nga netët, nata e xhuma, nëna ime qëndroi duke adhruar Allahun, derisa u shfaq agimi”. Ai thotë se e dëgjonte gjithmonë duke u lutur për besimtarët dhe besimtare, për njerëzit dhe për çështjet e përgjithshme të botës islame. Kur u gdhi, ai i tha: “O nëna ime, pse nuk lutesh për veten tënde, ashtu siç lutesh për të tjerët?” Ajo iu përgjigj: “O biri im, së pari është fqinji, pastaj shtëpia”.³

Nuk ka shpirtmirësi më të lartë se ajo e Fatime Zehrasë

Ky ishte adhurimi i Fatimes (Paqja qoftë mbi të!), i cili u shfaq dhe u reflektua në shoqërinë e saj me bamirësi dhe bujari. Mirësia e saj ndaj të varfërve ishte aq e madhe, saqë, kur Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe

² “El Menakib”, Ibn Shehrashub, vëll. 3, f. 341.

³ “Biharul Enuar”, i eruditit El Mexhlisi, vëll. 86, f. 313.

mbi familjen e tij!) dërgoi një burrë të moshuar e të varfër në shtëpinë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha të kërkonte nevojën e tij prej tyre, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha atij një lëkurë, mbi të cilën flinin Hasani dhe Hyseni (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ajo nuk kishte asgjë tjetër përveç asaj. Ajo i tha që ta merrte, ta shiste dhe të përfitonte nga çmimi i shtrojës.

Personaliteti gjithëpërfshirës i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*)

Ne kemi nevojë, më shumë se kurrë, në këtë përvjetor të dhimbshëm, që të marrim frymëzim nga Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*); të jetë e pranishme në realitetin tonë, të jetë e pranishme te ne, me jetën, me fjalët dhe me qëndrimet e saj në fushat e adhurimit, të dijes, të luftës dhe të misionit hyjnor, si edhe në përballjen me padrejtësinë dhe devijimin.

Duke vepruar kështu, ne tregojmë përkushtim të singertë ndaj Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) në përvjetorin e ngjitjes së saj te Zoti i saj.

Fatimja nuk dëshiron që vetëm të jemi të singertë ndaj saj, të shprehim gëzim në përvjetorin e lindjes së saj apo të derdhim lot në ditën e martirizimit të saj, apo vetëm të përmendim padrejtësinë që iu bë. Por ajo dëshiron prej nesh

që ta marrim shembull, dhe të punojmë për qëllimin për të cilin ajo duroi, u pikëllua dhe sakrifikoi.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) është shkolla e pastërtisë, e durimit dhe e drejtësisë që nuk shuhet kurrë. Ajo nuk kërkon prej nesh thjesht emocione kalimtare, por kërkon që shpirti të zgjohet dhe zemra të marrë vendime që pasqyrojnë dritën e saj. Shembulli i saj është një ftesë që besimtari të ngrihet mbi vetveten, të luftojë prirjet e dobëta dhe të qëndrojë në anën e së vërtetës, edhe kur ajo është e hidhur.

Ajo që duroi Fatimja, nuk ishte thjesht dhimbje, por një amanet i shenjtë që kërkon bartës të rinj në çdo brez, që t'i ngrenë përsëri flamujt e drejtësisë, mirësisë dhe sakrificës. Kush ecën në gjurmët e saj, ecën në gjurmët e dritës profetike që i jep shpirtit qetësi dhe jetës kuptim.

Kush e merr Fatimen shembull, nuk e merr vetëm si figurë të lavdishme të së kaluarës, por si udhërrëfyesë të së tashmes. Ajo i mëson njeriut si të jetë prind me mëshirë, bashkëshort/e me drejtësi, besimtar/e me zemër të pastër dhe shërbëtor/e i/e singurtë i Zotit të tij/saj. Në çdo vepër të vogël, në çdo fjalë të matur, në çdo sakrificë të heshtur, besimtari bëhet pasqyrë e moralit të saj.

Dhe, kur njeriu e bën zemrën vendbanim të virtyteve të Fatimes, atëherë edhe shpresa për ndërmjetësimin e saj bëhet më e afërt, edhe rruga drejt Xhenetit më e

shndritshme, sepse drita e saj nuk është vetëm histori, por frymëzim që e mban të gjallë shpirtin në çdo hap të jetës.

Le t'i kërkojmë Allahut që të na japë sukses, në mënyrë që të meritojmë dashurinë e saj, ndërmjetësimin e saj dhe takimin me të në Xhenetet e përjetshme!

Paqja qoftë mbi Fatimen ditën që lindi, ditën që u kthye në praninë e Zotit të saj dhe ditën kur do të ringjallet e gjallë, për të marrë atë që Allahu ka përgatitur prej mirësive të përjetshme!

Ma. Isra MERJA

FJALA E BOTUESIT

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), gruaja që mishëron nderin dhe besimin

Ka njerëz që vijnë në botë si dritë, jo si qenie të zakonshme. Ka gra që nuk ecin mbi tokë si të tjerat, por shkelin mbi një shteg të shenjtë, të cilin vetë pastërtia e krijoi. Mes këtyre shpirtrave të rrallë që Zoti i sjell për të treguar se çfarë është virtyti, butësia dhe madhështia e vërtetë, qëndron e vetme, e pakrahasueshme dhe e paarritshme: **Fatime Zehraja**, bija e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo nuk ishte thjesht një grua, por mishërimi i nderit, i besimit, i moralit hyjnor dhe i së vërtetës që nuk shuhet.

Në historinë e njerëzimit, ka figura që nuk maten me vitet që kanë jetuar, por me dritën që kanë lënë pas. Ka gra që nuk përmenden vetëm për shkak të lidhjes së tyre familjare, por, sepse shpirti i tyre e ka tejkaluar kufirin e tokës dhe është ngjitur në qiell. Në krye të këtyre figurave qëndron Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), bija e Profetit

Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e cila u bë simboli më i pastër i nderit, besimit dhe pastërtisë.

Ajo lindi në një periudhë, kur errësira shpirtërore kishte mbuluar Arabinë, kur zemrat ishin të forta si shkëmbi dhe mendjet të mbyllura si shkretëtira. Por ardhja e saj ishte si një agim i butë mbi një natë të gjatë.

Që në momentin e parë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kuptoi se krijesa që mbante në krahë nuk ishte një fëmijë i zakonshëm, por një dritë hyjnore, e cila do ta shndërronte jetën e tij dhe jetën e umetit. Ai e mbështolli me dashuri, e rriti me moral dhe e mbushi me mirësinë e shpalljes.

Që nga fëmijëria e saj, shtëpia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte shkolla e saj. Ajo pa mundimet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), qëndresën e tij, lotët, nderin dhe përkushtimin e tij ndaj misionit hyjnor.

Këto pamje nuk e trishtuan, por e bënë më të fortë, më të qetë dhe më të ndërgjegjshme për rolin e saj në këtë botë.

Fatimja nuk u rrit si një vajzë e thjeshtë, por u rrit si dritë mbi dritën, e bekuar me butësi, zgjuarsi dhe

devotshmëri të jashtëzakonshme. Në shpirtin e saj u derdh pastërtia e shpalljes dhe në moralin e saj u mishërua madhështia e profetësisë.

Emri i saj është i lidhur me nderin, sepse ajo jetoi çdo ditë duke e ngritur veten mbi nevojat e dynjasë. Emri i saj është i lidhur me besimin, sepse ajo nuk u lëkund as kur padrejtësia e rrethoi dhe as kur bota u përmbys kundër Ehli Bejtit. Emri i saj është i lidhur me dritën, sepse ajo ishte nënë e prijësve të Xhenetit, bashkëshorte e Aliut dhe boshti rreth të cilit rrotullohet morali i pastër i Islamit.

Prandaj, të flasësh për Fatime Zehranë nuk është thjesht të tregosh histori, por është të prekësh kufirin e dritës, të qëndrosh para një personaliteti që tejkalon kohën, të mësohesh me butësinë që nuk njeh urrejtje dhe me sakrificën që nuk kërkon shpërblim.

Ajo është gruaja që mishëron nderin dhe besimin, gruaja që ishte e gatshme të sakrifikonte gjithçka për të vërtetën, gruaja që e ktheu shtëpinë e saj në një qendër drite dhe shpirtin e saj në një thesar virtyti.

Historia e saj është si aroma e një luleje që nuk vyshket kurrë, një aromë që mban freski edhe pas 14 shekujsh. Ajo është zemra e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe zemra e besimit dhe për këtë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

“Fatimja është pjesë e imja; kush e ka zemëruar atë, më ka zemëruar mua”.

Ky deklaram nuk është një fjali e zakonshme, por një shpallje e statusit të saj.

Çdo faqe e jetës së saj përbën një dritare të veçantë, ku shfaqen virtytet më të larta të nderit, besimit dhe pastërtisë. Prandaj, për të kuptuar plotësisht figurën e saj, duhet të shohim secilin prej këtyre dimensioneve në mënyrë të veçantë, duke i analizuar me vëmendje dhe duke i marrë si shembuj që flasin vetë.

Pikërisht, për këtë arsye, më poshtë do të paraqesim disa prej shtyllave kryesore që ndriçojnë personalitetin e saj të jashtëzakonshëm.

Fatimja, gruaja që mishëron nderin dhe besimin

Në të shohim kulmin e virtytit të gruas myslimane: besimin e palëkundur, nderin e papërlyer, devotshmërinë e thellë, guximin e qetë dhe mençurinë hyjnore. Ajo është shembulli që nuk plaket dhe modeli që nuk zëvendësohet. Fatimja është shkolla ku vajzat mësojnë nderin, gratë mësojnë durimin, nënat mësojnë butësinë, dhe njerëzit mësojnë përlulësinë.

Ajo nuk ishte vetëm bijë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*); ajo ishte pasqyrimi më i pastër i shpirtit të tij. Ajo nuk ishte vetëm nënë, por nënë e dy prijësve të Xhenetit. Ajo nuk ishte vetëm bashkëshorte, por mbështetje e Imam Aliut dhe shtylla e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ajo është drita që nuk shuhet as në tokë dhe as në qiell.

Prandaj, kur flasim për Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk flasim për një figurë historike. Flasim për një realitet shpirtëror, një dritë që lëviz mes nesh, një edukatore të zemrave, një shembull të përjetshëm të asaj që do të thotë nder, besim dhe madhështi.

Fatimja, shkëlqimi i dritës që zbret nga qielli

E bija e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u rrit në një shtëpi, ku shpallja zbriste si shi mëshire, ku morali ngrihej në shkallën më të lartë të njerëzimit. Ajo pa vuajtjet e të atit, padrejtësitë, rezistencën, betejat, dhe qëndroi pranë tij si një mal i palëkundur.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Pashë se sa shumë mundohej Profeti në thirrjen e tij, por nuk shihja njeri që t’i fshinte lotët dhe t’i largonte shqetësimet e tij si Fatimja”.

Që në moshë të vogël, ajo ishte strehë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte vendi ku ai gjente paqe pas lodhjes. Kur politeistët e Mekës e hidhnin pluhurin mbi të, vajza e vogël vinte me duart e saj të buta dhe ia pastronte flokët. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ngrinte kokën, ia puthte dorën dhe thoshte: **“Ti je nëna e babait tënd”**. Një titull që askush në botë nuk e ka pasur.

Fatimeja, modeli i pastërtisë hyjnore

Së bashku me Imam Aliun, Imam Hasanin dhe Imam Hysenin, ajo përfshihet te “Ahlul Kisa” – *njerëzit nën mantelin e pastërtisë*. Kur Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i mbuloi me mantel, tha:

“O Zot, këta janë Ehli Bejti im! Pastroji ata me një pastrim të plotë!” Këto fjalë dhe ky akt profetik nuk ishin vetëm për nder, por për të shpallur se Fatimja është boshti i pastërtisë së Ehli Bejtit dhe shpirti i shtëpisë së profecisë.

Kur Fatimja hynte në dhomë, drita e saj errësonte dritën e yjeve

Drita që flitet këtu, nuk është fizike, por shpirtërore, dritë e diturisë, e devotshmërisë, e moralit të lartë.

Fatimeja, nderi i gruas myslimane

Ajo mishëroi çdo cilësi të lartë të besimit: turpin, modestinë, mençurinë, dinjitetin. Ajo ishte gruaja që foli pak dhe veproi shumë. Çdo hap i saj ishte ibadet, çdo buzëqeshje mëshirë, çdo lutje e saj ishte dritë mbi botën. Kur u martua me Imam Aliun, jeta e saj ishte thjeshtësi, sakrificë dhe punë e palodhur.

Në një nga ditët më të vështira, Imam Aliu e gjeti atë duke bluar elb me dorë dhe duke i rënë gjuri nga lodhja. Ai e pyeti pse nuk kërkonte nga babai një shërbyese. Fatimja u përgjigj: “Unë turpërohem t’i kërkoj babait tim diçka materiale, kur ai është ngarkuar me misionin e gjithë umetit”.

Në vend të shërbyeses, Profeti i mësoi “Tesbihun e Fatimes”: 33 herë Subhanallah, 33 herë Elhamdulilah, 34 herë Allahu Ekber. Kjo u bë dhurata më e ndritshme për umetin.

Fatimja, zëri i së vërtetës

Ajo nuk qëndroi e heshtur, kur padrejtësia u ngrit mbi jetën politike të kohës. Ajo mbajti hutben e saj të famshme në xhaminë e Profetit, e njohur si “Hutbetu’l-Fedek” – një fjalim që tronditi Medinën dhe që mbetet monument i guximit. Me një elokuencë që pasqyronte diturinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo përshkroi të drejtat, padrejtësitë dhe parimet e drejtësisë islame.

Në veprën “Biharul Enuar” transmetohet se një burrë tha: “Nuk kam dëgjuar askënd më elokuent se Fatimja, përveç babait të saj”. Ajo fliste si një grua që mbante barrën e shpalljes në zemër.

Dashuria e Profetit Muhamed (a.s) për të

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk e trajtonte Fatimen si një bijë të zakonshme. Dashuria e tij për të ishte dashuri hyjnore, sepse edhe Allahu e deshi Fatimen. Sa herë hynte ajo në dhomë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ngrihej në këmbë. Ai e puthte në ballë dhe e ulte në vendin e tij.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Allahu zemërohet, kur zemërohet Fatimja dhe kënaqet, kur kënaqet ajo”.⁴

Ky nderim i jashtëzakonshëm që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i bënte së bijës nuk ishte një gjest i zakonshëm familjar, por një dëshmi e vlerës së saj të rrallë shpirtërore. Fatimja ishte simbol i pastërtisë, devotshmërisë dhe moralit të përsosur; ajo ishte njeriu që përfaqësonte në mënyrë të plotë mesazhin e Islamit në formën më të butë dhe më të thellë njerëzore.

Respekti i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndaj saj shprehte faktin se ajo mbante në zemër dritën e shpalljes dhe amanetin e familjes së tij. Kur ai ngrihej për të, në të vërtetë nderonte vlerat që ajo mishëronte: besimin, sakrificën, mirësinë dhe qëndrueshmërinë në të vërtetën.

Marrëdhënia e tyre ishte pasqyrim i harmonisë së shpirtit, ku babai profet dhe bija e pamposhtur ndanin të njëjtin mision: të ruanin dritën e fesë dhe të edukonin botën me shembull.

Përmes Fatimes, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëshironte t'i

⁴ “Kenzul Ummal”, vëll. 12 f. 111.

mësonte umetit se nderi i gruas, vlera e karakterit dhe dija e shpirtit janë shtyllat e një shoqërie të drejtë dhe të ndriçuar.

Me rastin e ditëlindjes së Fatime Zehrasë, shoqata “Flladi” ka përgatitur për besimtarët librin e titull: “Fatime Zehraja në fjalët e Imam Khameneit”.

Urojmë që të përfitojmë të gjithë nga ky libër i vyer, me qëllim që të njihemi sa më shumë me vajzën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*)

Falënderojmë nga zemra bashkëpunëtorët e nderuar dhe e lusim Allahun që t’u japë atyre mbarësi në këtë jetë dhe t’i shpërblejë me të mirat e Tij të pafundme në Jetën Tjetër!

Shoqata “Flladi”

Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*) në fjalët e Imam Ali Khameneit

Fatimja, mrekullia e Islamit⁵

Ajo është një mrekulli e Islamit, që arriti një pozitë të lartë dhe u bë Zonja e grave të botëve⁶, megjithëse jetoi vetëm pak vite. Ajo i tejkaloi të gjitha gratë në madhësi dhe shenjtëri përgjatë gjithë historisë së njerëzimit.

5 Nga një fjalë e Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (Paqja qoftë mbi të!), viti 1428 hixhri.

6 Nga Ibn Abasi transmetohet se një ditë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) ishte ulur, ndërsa pranë tij ishin Aliu, Fatimja, Hasani dhe Hyseni (Paqja qoftë mbi ta!). Ai tha: “O Allah, Ti e di se këta janë familja ime dhe njerëzit më të dashur për mua. Prandaj, dua je atë që i do ata, urreje atë që i urren ata, mbaje për mik atë që i merr për miq, bëhu armik i atij që u bëhet armik, ndihmoje atë që i ndihmon ata dhe bëji të pastër nga çdo ndotje, të mbrojtur nga çdo mëkat, dhe përforcoji me shpirtin e shenjtë”.

Pastaj tha: “O Ali, ti je imami i umetit tim dhe pas meje je zëvendësi im mbi ta. Ti je udhëheqësi i besimtarëve drejt Xhenetit. Unë po e shoh vajzën time Fatimen, Ditën e Kiametit, duke ardhur mbi një deve drite, me shtatëdhjetë mijë engjëj në të djathtën e saj, shtatëdhjetë mijë në të majtën, shtatëdhjetë mijë para saj dhe shtatëdhjetë mijë pas saj, teksa i udhëheq gratë besimtare të umetit tim drejt Xhenetit. Dhe çdo grua që fal pesë namazet e ditës e të natës, agjëron Ramazanin, bën Haxh në Shtëpinë e shenjtë të Allahut, jep zekatin e pasurisë së saj, i bindet burrit të saj dhe e merr Aliun për mik, pas meje, hyn në Xhenet, me ndërmjetësimin e vajzës sime, Fatimes. Ajo, me të vërtetë, është Zonja e grave të botëve”.

I thanë: “O i Dërguari i Allahut, a është ajo Zonja e grave të botës së vet?”

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Ajo pozitë i takon Merjemes, bijës së Imranit. Kurse vajza ime, Fatimja, është Zonja e grave të botëve nga të parat deri te të fundit. Dhe ajo, sa herë që ngrihet në mihrabin e saj, e përshëndesin shtatëdhjetë mijë engjëj të afërt dhe e thërrasin me fjalët me të cilat engjëjt e thirrën Merjemen: ‘O Fatime, Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka zgjedhur mbi gratë e botëve’”. (El Emalij, i Shejkh Sadukut, f. 574–575.)

Cila është ajo energji dhe ajo forcë e thellë e brendshme, që brenda një periudhe kaq të shkurtër e shndërroi këtë njeri në një oqean të pafund të dijes, adhurimit, shenjtërisë dhe përsosmërisë shpirtërore?

Vetë kjo është mrekullia e Islamit.

Arritja e gradës së “Sidikëve” nëpërmjet adhurimit⁷

Vlera e Fatime Zehrasë (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) qëndron në adhurimin e saj ndaj Allahut.⁸ Po të mos ishte adhurimi i saj, ajo nuk do të cilësohej si “Siddîkatul Kubra” (E Vërtetëshmja e madhe). Sidik është njeriu që e shfaq në sjelljet dhe veprat e tij atë që beson dhe thotë. Sa më i madh të jetë ky “sidik”, aq më e madhe është vlera e njeriut dhe atëherë ai quhet sidik, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me**

7 Nga një fjalë e Imam Khameneit mbajtur në përvjetorin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1426 hixhri.

8 I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: “Për sa i përket vajzës sime, Fatimes, ajo është Zonja e grave të botëve, nga të parat deri te të fundit. Ajo është pjesë e imja, është drita e syve të mi, është fryti i zemrës sime, është shpirti im mes brinjëve të mia. Ajo është hyjnesha njerëzore. Kur ngrihet në mihrabin e saj, para Zotit të saj, ndriçimi i saj shfaqet për engjëjt e qiellit ashtu siç shfaqen yjet për banorët e tokës. Allahu i Madhëruar u thotë engjëjve të Tij: ‘O engjëjt e Mi, shikoni robërshën Time, Fatimen, zonjën e shërbëtoreve të Mia, që qëndron para Meje e dridhet nga frika ndaj Meje dhe ka ardhur me zemër të prirur drejt adhurimit Tim. Ju bëj dëshmitarë se unë i kam shpëtuar pasuesit e saj nga zjarri’”. (“El Emalij”, i Shejkh Sadukut, hadijthi 24, faqe 100.)

profetët, me të sinqertët⁹, me dëshmorët dhe me të drejtët!" ¹⁰, ku përmendja e të sinqertëve (sidikëve) vjen menjëherë pas profetëve.

Kjo zonjë madhështore ishte e sinqerta e madhe, domethënë më e mira. Madhështia e saj si sidike buronte nga adhurimi i saj ndaj Allahut. Pra, themeli është adhurimi i Allahut. Kjo nuk është e veçantë vetëm për Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe babai i saj, burimi i virtyteve të të gjithë të pagabueshmëve, prej detit të pafund të qenies së të cilit Aliu dhe Fatimja (*Paqja qoftë mbi ta!*) janë vetëm disa pika – vlera e tij pranë Allahut ishte, po ashtu falë adhurimit të tij. Ne dëshmojmë: “Dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij”; dhe këtu përmendja e robërisë vjen para dërgimit të profecisë. Madje, vetë profecia iu dha atij për shkak të adhurimit që kryente, sepse Allahu e di krijesën e Vet dhe atë që krijon Dora e Tij.

A nuk e lexojmë në vizitën e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*): “Allahu që të krijoi, të sprovoi para se të të krijonte”?!¹¹

9 Termi kuranor i përdorur për epitelin “i sinqertë”, është fjala “siddik”. Ajo nënkupton ata ndjekës të profetëve, të cilët ishin më të parët që u besuan atyre. Kjo është grada më e lartë që një besimtar mund të arrijë.

10 Sure “En Nisa”, ajeti 69.

11 Ibrahim ibn Muhamed ibn Isa El Aridhi ka transmetuar atë që Ebu Xha’ferri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë një ditë: “Kur të shkosh te varri i gjyshes sate, Fatimes (Paqja qoftë mbi të!), thuaj: ‘O e sprovuar, Allahu që të krijoi ty para se të krijonte të tjerët, të sprovoi dhe të gjeti të duruar në atë me çfarë të sprovoi. Ne besojmë se jemi mbështetësit e tu, besimtarë në ty dhe të durueshëm ndaj asaj që na solli babai yt (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe na solli pasuesi i tij. Ne të lutemi, nëse jemi të sinqertë me ty, që të na bashkosh, për shkak të besimit tonë tek ata, me lajmin e gëzuar, që ta gëzojmë veten se jemi pastruar përmes

Gjuha është e paaftë të shpjegojë madhështinë e saj¹²

Për sa i përket gradës së të Sinqertës së Pastër (*Paqja qoftë mbi të!*), gjuha jonë është e paaftë ta shpjegojë atë. Nuk është e mundur të përshkruhet pozita e saj, sepse ajo është përtej kufijve të shprehjeve tona. Megjithatë, është e mundur që mendjet tona t'u afrohen kuptimeve të saj, përmes gjuhës së artit. Pikërisht, për këtë arsye unë këmbëngul te lavdet dhe poezitë islame: nuk mund të arrijmë thelbin e tyre në përshkrim, por mund t'i afrohem kësaj të vërtete, duke fluturuar me krahët e artit.

Natyrisht, ata që pastrojnë zemrat e tyre, që i pastrojnë veprat e tyre, që ecin në rrugën e devotshmërisë dhe largohen nga ndotjet që përfshijnë njerëz si unë, mund ta shohin atë të vërtetë. Por edhe këta nuk janë të aftë të përshkruajnë atë që shohin nga të vërtetat dhe dritat e shenjta të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), ndër ta edhe e Pastra e madhe, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*).

Profeti i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Babai i saj të jetë flijim i saj!”¹³

velajetit tend’’. (“Tehdhijbul Ahkam”, i Shejkh Tusiu, vëll. 6, f. 9, Hadithi 12; “Misbahul Mutehexxid, i Shejkh Tusit, f. 711; “Biharul Enuar”, i eruditit Mexhlisi, vëll. 97, f. 194, Hadithi 11.

12 Nga një fjalë e mbajtur e Imam Khameneit, në përvjetorin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1425 hixhri.
13 Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) kthehej nga udhëtimi, fillimisht shkonte te Fatimja. Hynte tek ajo dhe qëndronte gjatë. Një herë doli për një udhëtim dhe gjatë mungesës së tij, Fatimja përgatiti dy byzylykë argjendi, një varëse, dy vathë dhe vendosi një perde në derën e shtëpisë, për nder të ardhjes së babait të saj dhe bashkëshortit të saj, Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ngrihej në këmbë, sa herë që Fatimja hynte tek ai.¹⁴ Sigurisht që këto janë ndër shenjat e madhështisë së saj.

Gjithashtu, vështrimi i botës islame, si të shi'itëve, ashtu edhe të sunitëve, ndaj kësaj Zonje madhështore, me nderim dhe respekt, është një tjetër dëshmi për këtë, sepse nuk është e mundur që të gjithë të mençurit, dijetarët dhe mendimtarët, me gjithë dallimet e tyre në besime, të jenë të bashkuar gjatë gjithë historisë në lavdërimin e një personi, përveçse për një madhështi të jashtëzakonshme. Dhe kjo madhështi ishte e përqendruar tek një zonjë e re, mosha e së cilës nuk kalonte tetëmbëdhjetë pranvera; ndërsa mosha më e gjatë e përmendur në libra për Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*) luhetet mes tetëmbëdhjetë dhe njëzet e dy vitesh.

Nga mënyra se si e nderonte atë Emirul-Mu'minini (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nga ajo që na ka ardhur, në lidhje me

Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) u kthye dhe hyri tek ajo, shokët e tij mbetën duke pritur jashtë, pa e ditur, nëse duhej të prisnin apo të largoheshin, ngaqë ai qëndroi gjatë brenda. Pastaj Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) doli dhe në fytyrën e tij shihej shqetësim. Ai u ul pranë minberit. Fatimja mendoi se e gjithë kjo ndodhi për shkak të byzylykëve, varësës, vathëve dhe perdes që ai pa tek ajo. Kështu ajo hoqi varësen, vathët, byzylykët dhe hoqi perden, i mbledhi dhe ia dërgoi Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), duke i thënë: "Thuaji: Vajza jote të dërgon selam dhe të thotë t'i vendosësh këto në rrugën e Allahut".

Kur ia sollën Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), ai tha: "E ka bërë. Qoftë jeta e babait flijim për të!". Këtë e përsëriti tri herë.

Pastaj tha: "Bota nuk është për Muhamedin dhe as për familjen e Muhamedit. Sikur bota të kishte vlerë tek Allahu sa krahu i një mushkonje, Ai nuk do t'i jepte një jobesimtari as një pikë ujë". Pastaj u ngrit dhe hyri sërish tek ajo". ("Hiljetul Ebrar, Sejid Hashim Bahrani, vëll. 1, f. 207-208.)

14 Referencat e haditheve: "Sahih Tirmidhi", vëll. 2, f. 319; "Sunen Ebi Davud", vëll. 33, K. "Ç'solli tradita rreth qëndrimit në këmbë"; Mustedrek es-Sahihajn, Hakim Nejsaburi, vëll. 3, f. 154.

të, në formë hadithesh dhe transmetimesh, ne e kuptojmë madhështinë që valon në fjalët e Imamëve të pastër në drejtim të Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Secili prej Imamëve është një det i stuhishëm njohurie, që shuan etjen e njerëzimit dhe u jep jetë. Të gjitha këto burime burojnë nga syri i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*); transmetimet e të sinqertëve (Imamit Sadikut), madhështia e Imamëve Musa ibn Xhaferri, Rida dhe të tjerëve pas tyre deri tek Imami i Pritur (Shpirtrat tanë u qofshin flijim!), janë vetëm pjesë të vogla të atij thesari që nuk shteron kurrë.

Madhështia e saj¹⁵

Kjo është madhështia e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilën ne dëshirojmë ta marrim si shembull. Ajo ishte një grua e re, që jetonte një jetë të thjeshtë, vishte rrobat e të varfërve, drejtonte shtëpinë e saj dhe kujdesej për fëmijët e saj; megjithatë ajo ishte një mal madhështor dijeshe dhe një oqean i pakufishëm i shkencës.

Allahu në Kur'an ka sjellë shembullin e katër grave: dy prej tyre, si shembull për të mirë dhe dy, si paralajmërim për të këqijtë: **"Allahu solli një shembull për ata që**

15 Nga një fjalë e mbajtur e Imam Khameneit, në përvjetorin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1425 hixhri.

mohuan: gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin nën dy rob tanë të drejtë, por i tradhtuan ata”.¹⁶

Këto dy gra janë model për njerëzimin mohues në të gjithë historinë, sepse, kur Allahu deshi të paraqiste një shembull për ata që mohojnë mirësitë e Tij, nuk solli si shembull Faraonin apo Nemrudin, por solli gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Dy gra, për të cilat të gjitha dyert e mirësive ishin të hapura, mundësitë për ngritje dhe madhërim ishin të pranishme, bashkëshortët e tyre ishin profetë dhe ato jetonin nën kujdesin e tyre. Me këtë, argumenti ishte plotësuar ndaj tyre, por megjithatë ato i tradhtuan.

Këtu tradhtia nuk është domosdoshmërisht tradhti seksuale, por tradhti besimi dhe sjelljeje. Edhe pse burrat e tyre ishin profetë, kjo nuk u vlejti asgjë te Allahu, sepse Allahu nuk bën padrejtësi dhe nuk favorizon askënd; mëshira dhe butësia e Tij funksionojnë sipas llogarisë dhe drejtësisë.

Përballë këtyre, Allahu solli dy gra si shembull për besimtarët: **“Dhe Allahu solli shembull për ata që besuan: gruan e Faraonit, e cila tha: “O Zoti im! Më ndërto pranë Teje një shtëpi në Xhenet, dhe më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij, dhe më shpëto nga populli zullumqar”.**¹⁷

¹⁶ Sure “Et Tahrîm”, ajeti 10.

¹⁷ Sure “Et Tahrîm”, ajeti 11

Kjo grua nuk u josh nga pallati i Faraonit. Edhe pse jetonte në sarajet faraonike, kishte ndoshta një familje të pasur dhe jetonte jetë të rehatshme e luksoze, ajo nuk u magjeps nga kjo botë. U drejtua drejt thirrjes së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe besoi në të. Ajo u largua nga gjithë shkëlqimet e kësaj jete dhe i kërkoi Allahut t'i ndërtonte një shtëpi tek Ai në Xhenet, duke pëlqyer kënaqësinë e Botës Tjetër mbi kënaqësitë e kësaj bote.

Gruaja e dytë është Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*):
“Dhe Merjemja, bija e Imranit, e cila ruajti pastërtinë e saj, dhe Ne frymëzuam në të nga shpirti Ynë”.¹⁸

Këto janë vlera njerëzore të përgjithshme. Këto gra nuk janë shembuj vetëm për gratë, por modele për gjithë njerëzimin. Edhe Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) i përmbajti të gjitha këto virtyte.

Megjithëse Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) u zgjodh mbi gratë e botës, transmetimet e kanë sqaruar se ajo ishte më e mira e grave të kohës së vet. Ndërsa Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është Zonja e grave të botëve në të gjitha periudhat e historisë.¹⁹ Ajo është shembull. Sa shumë kemi nevojë sot, o vëllezër, për këtë shembull!

¹⁸ Sure “Et Tahrim”, ajeti 12.

¹⁹ “El Emali”, i Shejkh Sadukut, f. 574–575.

Shembulli më i qartë i “Keutherit”²⁰

Pasi djemtë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u ndanë nga jeta në Mekë, njëri pas tjetrit, përqeshësit u gëzuan. Ata që e kufizonin vlerën vetëm te pasuria, te fëmijët, te pushteti dhe madhështia e kësaj bote, e fyen Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e quajtën “*ebter*”, pra, pa pasardhës, duke supozuar se, me vdekjen e tij, do të zhdukej çdo gjurmë dhe ndikim i tij. Atëherë Allahu i shpalli këtë sure, për ta ngushëlluar zemrën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për t’i sqaruar atij dhe myslimanëve një të vërtetë madhështore, duke thënë: **“Ne të kemi dhënë ty Keutherin”**²¹, domethënë atë të vërtetë të madhe, të shumtë dhe të shtuar.

Shembujt e “Keutherit” për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë të shumtë, por ndër më të shquarit është vetë qenia e shenjtë e Fatime Zehrasë, të cilën Allahu e bëri pasardhëse materiale dhe shpirtërore të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Dhe përkundër iluzioneve të armiqve që u gëzuan për vdekjen e djemve të tij, pikërisht kjo bijë e bekuar dhe shpirtmadhe, u bë shkak që emri, mesazhi, udhëzimi dhe mësimet e Profetit Muhamed (*Paqja*

20 Nga një fjalë e mbajtur e Imam Khameneit, në përvjetorin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1420 hixhri.

21 Sure “El Keuther”, ajeti 1.

e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) të mbeten të pavdekshme në një mënyrë që nuk është parë tek asnjë fëmijë tjetër madhështor.

Prej saj erdhën njëmbëdhjetë imamë, yje të ndritshëm që shndritën zemrat e njerëzimit me dritën e dijes islame, e ringjallën Islamin, e sqaruan Kur'anin, përhapën njohuritë hyjnore, larguan shtrembërimet dhe mbyllën dyert e keqpërdorimit të fesë.

Njëri prej këtyre njëmbëdhjetë imamëve është Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilin i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit"*.²² Dhe: *"Hyseni është anija e shpëtimit dhe drita e udhëzimit"*.²³

22 I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit. Allahu e do atë që e do Hysenin. Hyseni është një nga djemtë e brezave"*. (*"Kamalu Ez Zijarat"*, Xhafer ibn Muhamed ibn Kuleijeh, f. 116.)

23 Hysen ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi ta!*) ka thënë: *"Hyra te i Dërguari i Allahut, ndërkohë që pranë tij ishte Ubej ibn Kabi"*.

- Mirë se erdhe, o Ebu Abdullah, o zbukurimi i qiejve dhe i tokave! – më tha Profeti (a.s).
- Si mund të jetë, o i Dërguari i Allahut, dikush tjetër përveç teje zbukurimi i qiejve dhe i tokave? – e pyeti Ubej ibn Kabi.
- O Ubej, për Atë që më dërgoi me të vërtetën si profet! Vlera e Hysenit në qiell është më e madhe se në tokë. Në të djathtën e Arshit është shkruar për të: Dritë udhëzimi, anije e shpëtimit, imam i mirësisë dhe begatisë (pa dobësi), nder dhe krenari, det dijeje dhe thesar. Allahu i Madhëruar ka vendosur në të një pikë të pastër, të bekuar dhe të dëlirë... – deri në fund të hadithit.

"Biharul Enuar", vëll. 42, f. 262; vëll. 36, f. 205; *"Kemalud Dijn"*, f. 154; *"Ujunul Akhbar"*, vëll. 1, f. 62; *"A'lamul Uara"*, f. 378.

Personi, revolucion i dhe martirizimi i tij sollën pasoja dhe bekime të pamatshme përgjatë historisë islame. Ai është prej pasardhësve të Fatime Zehrasë.

Prej këtyre diejve të ndritshëm janë Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilëve u detyrohet përhapja e dijes islame, jo vetëm dijes shi'ite, por edhe shumë prej imamëve dhe dijetarëve të njohur të Ehli Sunetit kanë përfituar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shkencat e tyre.

Ky Keuther që rrjedh me bollëk dhe vazhdon të shndrisë, e mbushi gjithë botën islame me pasardhës të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Edhe sot ka mijëra, madje qindra mijëra familje të njohura në botën islame që janë trashëgimi e kësaj gruaje të madhe. Po ashtu, mijëra pishtarë të udhëzimit në botë dëshmojnë për vazhdimësinë shpirtërore të këtij rrugëtimi dhe të këtij personaliteti të shenjtë.

Nuk është e mundur të perceptohen rangjet e saj shpirtërore²⁴

Jeta e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) i ngjan një legjende historike, për shkak të madhështisë së saj dhe mrekullive që përmban. E vërteta është se ne nuk jemi të aftë t'i kuptojmë rangjet e saj shpirtërore, madje as t'i përfytyrojmë ato me mendjet tona të kufizuara. Megjithatë, ajo që arrijmë të shohim me vështrimin tonë sipërfaqësor, është tepër e madhe.

Jeta e saj e shkurtër, nga fëmijëria te adoleshenca e deri te jeta bashkëshortore, është e mbushur me domethënie të thella.

A mund të bëhej kushdo bashkëshorte e Prijësit të besimtarëve, Aliut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*)? Madhështia e Aliut është e tillë, që para saj do të shkriheshin edhe malet më të forta. Vetë roli i të qenit bashkëshortja e tij është një shenjë e madhe madhështie.

Por shikoni se si silleshin këta dy bashkëshortë! Si i drejtoheshin njëri-tjetrit dy personalitete që janë përtej çdo aftësie të imagjinatës sonë?

²⁴ Nga një fjalë e mbajtur e Imam Khameneit, në përvjetorin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1420 hixhri.

Jeta e saj bashkëshortore²⁵

Shembulli tjetër manifestohet në jetën e saj bashkëshortore. Disa mund të mendojnë se martesë, për gruan, do të thotë të kujdeset për punët e shtëpisë, të përgatisë ushqimin, të rregullojë dhomat e shtëpisë dhe t'i pastrojë ato dhe, kur burri vjen nga puna, t'i shtrojë jastëkun, ashtu siç bënin të vjetrit. Por, bashkëshortësia nuk do të thotë vetëm kaq. Shikoni se si ishte jeta bashkëshortore e Fatime Zehrasë.

Gjatë dhjetë viteve që Profeti i Zotit jetoi në Medinë, Fatimja jetoi me Emirul-Mu'mininin një jetë bashkëshortore që zgjati disa vite. Gjatë asaj periudhe ndodhën shumë beteja të mëdha e të vogla, rreth gjashtëdhjetë beteja dhe Aliu mori pjesë në shumicën e tyre.

Shikoni jetën e kësaj bashkëshorteje, e cila jetonte në shtëpinë e një burri që merrte pjesë vazhdimisht në beteja, sepse rezultatet e tyre vareshin nga pjesëmarrja e tij, që pa të cilin ato nuk do të fitonin. Përveç kësaj, jeta e saj ekonomike nuk ishte aspak e rehatshme apo e pasur; nuk tejkalonte atë që na është transmetuar për të në Fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Dhe ata u japin ushqim, nga dashuria për Të, të varfrit, jetimit dhe të zënit rob: Ne ju**

²⁵ Nga një fjalë e Imam Khameneit, drejtuar një grupi të rinjsh, 11 Muharrem 1419 hixhri.

ushqejmë vetëm për hir të Allahut²⁶, që do të thotë se ajo jetonte një jetë të varfër, edhe pse ishte vajza e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe udhëheqësit të umetit. Kjo do të thotë se ajo mbante plotësisht ndjenjën e përgjegjësisë.

Vëreni sa shumë forcë dhe qëndrueshmëri kërkonte kjo situatë e kësaj gruaje, një forcë që ajo e derdhte mbi këtë bashkëshort, në mënyrë që ai të lirohej nga brengat dhe shqetësimet e familjes e jetës, t'i sillte atij qetësi dhe paqe, dhe të edukonte fëmijët me atë edukim të lartë me të cilin ajo i edukoi. Nëse dikush thotë se Hasani dhe Hyseni ishin imamë dhe të ngjizur në dritën e pafajësisë ('isma), atëherë Zejnebi nuk ishte imam, por Fatimja e edukoi me një edukim të drejtë gjatë atyre viteve të shkurtra, sepse Fatimja nuk jetoi gjatë pas ndarjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga kjo botë.

26 Sure "El Insan, ajetet 8-9.

Një qiell i lartë që përmbante në gjirin e tij yjet e shndritshëm të vilajetit²⁷

Përgëzoj të gjithë të pranishmit e nderuar dhe të gjithë myslimanët, veçanërisht gratë në këtë vend islam, me lindjen e lumtur të “Keutherit të dritës dhe dijes”, e së sinqertës së pastër, të kënaqurës dhe të dëlirës, Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo lindje madhështore është një prej festave më të shquara islame, sepse Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është një personalitet i madh i shkallës së parë në Islam, madje i shkallës më të lartë përgjatë historisë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha asaj: “A nuk të pëlqen të jesh zonja e grave të botëve?” Ajo e pyeti: “Po Merjemja?” Ndërkohë që Kur’ani thotë se ajo ishte zonja e grave, Profeti iu përgjigj: “Merjemja ishte zonja e grave të kohës së saj, ndërsa ti je zonja e grave të hershme dhe të mëvonshme”.²⁸

Sikur personaliteti i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) të shfaqej qartë para mendjeve tona të thjeshta dhe shikimeve tona që shohin vetëm pranë, do të besonim edhe ne se ajo është vërtet zonja e të gjitha grave të botëve. Ajo është gruaja që, në jetën e saj të shkurtër, arriti shkallë shpirtërore dhe shkencore që barazojnë shkallët e profetëve dhe të evlijave.

27 Nga një fjalim i Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1418 hixhri.

28 “El Emali”, i Shejkh Sadukut, f. 574–575.

Në të vërtetë, Fatimja është një agim i ndritshëm, nga i cili u shfaq dielli i imametit, i vilajetit dhe i profetësisë. Ajo është një qiell i lartë, që në kraharorin e saj mbante yjet e shndritshëm të vilajetit. Të gjithë imamët i jepnin asaj nderim dhe respekt të veçantë, një nderim që rrallë ia jepnin ndonjë personi tjetër.

Pozita e saj²⁹

Çdo gjë që ne themi rreth Zonjës Fatime Zehra (*Paqja qoftë mbi të!*), është e pakët. Në të vërtetë, ne nuk dimë se çfarë duhet të thuhet për Zehranë, as për çfarë duhet të mendojmë. Dimensionet ekzistenciale të kësaj hyrie njerëzore, të këtij shpirti të pastër dhe të esencës së profetësisë dhe vilajetit, janë të gjera, të pakufishme dhe të paarritshme për kuptimin e njeriut, në një shkallë të tillë që njeriu mbetet i habitur para saj.

Dhe, siç e dini, bashkëkohësia është ndër faktorët që shpesh ia pengon njeriut njohjen e drejtë të personaliteteve të mëdha. Shpesh, yjet më të ndritshëm të njerëzimit nuk janë njohur gjatë jetës së tyre nga bashkëkohësit, përveç në raste të rralla si te profetët dhe evlijatë, edhe ata janë njohur vetëm nga pak njerëz. Megjithatë, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe në kohën e saj, ishte e tillë, që nuk e

29 Nga një fjalim i Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve, 1415 hixhri.

madhëronin vetëm i ati i saj, bashkëshorti, bijtë dhe ithtarët besnikë të tyre, por ajo vlerësohej edhe nga ata që nuk kishin marrëdhënie të rregullta me të.

Shikoni librat që janë shkruar për Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*) ose rreth mënyrës së sjelljes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ndaj kësaj të madheje. Ato janë transmetuar edhe nga ata që përmendëm, si bashkëshortet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të tjerët. Është e njohur ajo që transmeton Aishja: “*Pasha Allahun! Nuk kam parë askënd në sjelljen, pamjen dhe udhëheqjen e tij më të ngjashëm me të Dërguarin e Allahut se sa Fatimen. Kur ajo hynte te i Dërguari i Allahut, ai çohet drejt saj*”.

Domethënë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ngrihej nga vendi i tij dhe shkonte drejt saj me përmallim dhe gëzim. Ky është kuptimi i “çohet drejt saj”, jo se ai ngrihej dhe qëndronte para saj në vend. Por ngrihej dhe shkonte tek ajo. Në disa transmetime të tjera nga Aishja, thuhet, gjithashtu: “*Ai e puthte atë dhe e ulte në vendin e tij*”.³⁰

30 Aishja ka thënë: “Nuk kam parë askënd që t’i ngjante më shumë në sjellje, qëndrim dhe udhëzim të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) se sa Fatimja. Kur ajo hynte te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), ai ngrihej për të, e puthte dhe e ulte në vendin e tij. Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) hynte tek ajo, ajo ngrihej nga vendi i saj, e puthte dhe e ulte në vendin e saj”.

(Referenca: “Sahih Tirmidhi”, vëll. 2, f. 319; “Sunen Ebi Davud”, vëll. 33, kapitulli “Ç”ka ardhur rreth qëndrimit në këmbë”; Mustedrek Es Sahihejn, Hakim Nejsaburi, vëll. 3, f. 154.)

Kjo është pozita e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Çfarë mund të thotë njeriu për vajzën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)? Çfarë mund të thuhet për këtë qenie të madhe?

Njohja jonë për të dhe lidhja jonë me të³¹

Madhështia e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), o të dashur, është e dukshme në jetën dhe veprën e saj. Këtu kemi dy çështje:

Çështja e parë: Sa e njohim ne Zehranë (Paqja qoftë mbi të!)?

Dashamirët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), gjatë gjithë historisë islame, janë përpjekur të tregojnë respekt ndaj familjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të lidhen me ta, veçanërisht me Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*), aq sa kanë mundur. Askush nuk duhet të mendojë se kjo grua e madhe është bërë e dashur për zemrat vetëm në kohën tonë. Po, në epokën tonë ajo që është në zemra, shprehet edhe me gjuhë; sepse është koha e Islamit dhe e sundimit të Kur'anit, koha e qeverisjes së Aliut dhe Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

31 Nga një fjalim i Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (*Paqja qoftë mbi të!*), viti 1415 hixhri.

Ajo ka qenë gjithmonë e dashur. Madje, universiteti më i vjetër islam në botën islame, që u përket shekujve të tretë dhe të katërt hixhri, mbante emrin e saj. Universiteti “El Ez’her”, në Egjipt emrin e tij e ka marrë nga Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*). Kalifët fatimi, të cilët qeverisnin Egjiptin në atë kohë, universitetet e tyre i emërtonin sipas saj. Gjatë shekujve, shi’itët janë përpjekur vazhdimisht të lidhen me këtë personalitet madhështor.

Çështja e dytë: Ne duhet ta gjejmë rrugën përmes yjeve

Kështu vepron njeriu i mençur. Kur një yll shndrit në qiell, ai nuk është vetëm për planetin Tokë. Thuhet se disa prej këtyre yjeve që duken si një pikë në qiell, në të vërtetë janë më të mëdhenj se e gjithë galaktika e Rrugës së Qumështit, e cila përbëhet nga miliona yje. Nuk ka kufi për fuqinë hyjnore, por syri ynë e sheh atë vetëm si një pikë të ndritshme.

Prandaj, njeriu i mençur, të cilit Allahu i ka dhënë sy, duhet të përfitojë prej këtij ylli në jetën e tij. Kur’ani thotë: **“Dhe me yllin ata udhëhiqen”**.³²

³² Sure “En Nahl”, ajeti 16.

Përqendrimi te përmbajtjet edukative fatimiane³³

Të dashur! Ju jeni bilbilat e kopshtit fatimian, lavdëruesit e Ehli Bejt, lexuesit e fjalës së Allahut: **“O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht”**.³⁴

Prandaj, përqendrohuni sa të mundeni në këto pika. Meqë mes jush ka disa poezi-thurës të mirë, të cilët sot kënduan vargje të mrekullueshme, me përmbajtje të lartë, shumë të pastra dhe pa asnjë mangësi, mbushini poezitë tuaja me këto përmbajtje edukative, udhëzuese dhe shpëtuese.

Udhëzimi nga drita e Zehrasë (Paqja qoftë mbi të!)³⁵

Nuk mjafton të thuhet se ky yll është i ndritshëm, pavarësisht se nuk mund ta krahasojmë, ashtu siç kemi thënë, mes asaj që shohim nga shkëlqimi dhe asaj që është realisht. Detyra është të udhëhiqemi nga ky yll dhe nga drita e tij.

33 Nga një fjalim i Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (Paqja qoftë mbi të!), 1415 hixhri.

34 Sure “El Ahzab”, ajeti 33.

35 Nga një fjalë e Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (Paqja qoftë mbi të!), 1415 hixhri.

Emri i saj dëgjohej nëpër fronte gjatë luftës, në periudhën e paqes dhe të rindërtimit, po ashtu edhe në përgatitjet përballë armiqve. Kjo gjendje është e pranishme kudo dhe, për këtë, falënderojmë Allahun.

Ky ndërmjetësim është i mirë dhe me vlerë, dhe Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) e do këtë frymë xhihadiste në çdo formë të mundshme. Ky është një ogur i mirë për të rinjtë mobilizues të këtij vendi. Ashtu siç ata e duan Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*), veprojnë sipas dëshirës dhe synimeve të saj dhe ecin në rrugën e saj, që është rruga e Allahut dhe rruga e adhurimit të Tij: **“Dhe që të më adhuron! Mua, kjo është rrugë e drejtë”**.³⁶

Virtytet dhe meritat shpirtërore³⁷

Në shumë transmetime thuhet se imamët i referoheshin *Mus'hafit të Fatimes* për çështje të ndryshme. Imami ka thënë: *“Në të nuk ka hallall dhe haram, por ka dijen e asaj që do të ndodhë”*.³⁸ Çfarë dije e lartë është kjo? Çfarë

36 Sure “Ja Sin”, ajeti 61.

37 Nga një fjalë e Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (*Paqja qoftë mbi të!*), 1419 hixhri.

38 Hamad ibn Uthmani ka transmetuar nga Ebu Abdullahu (Imam Xhaferr Sadiku):

- Zindikët (mohuesit e fshehtë) do të shfaqen në vitin njëqind e njëzet e tetë. Këtë e pashë në Mus'hafin e Fatimes”.
- Ç'është Mus'hafi i Fatimes? - e pyeta.

njohurie dhe urtësie pa të ngjashme është ajo që Allahu ia dhuroi një gruaje në moshën e rinisë? Ky është pozicioni shpirtëror i Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Këto çështje shpirtërore lidhen ngushtë me virtytet praktike, me frytin e përpjekjes së Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ky pozicion nuk jepet rastësisht ose falas. Vepra e njeriut ka ndikim të madh në fitimin e virtyteve dhe meritave të tilla.

Vajza që lindi në flakën e xhihadit të ashpër të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) në Mekë dhe që e ndihmoi dhe e mbështeti atë në Shu'etu Ebi Talib, ishte rreth 7-8 vjeçe, pak më shumë ose më pak sipas transmetimeve. Megjithatë, kjo vajzë i përballoi ato kushte.

Kush ia hiqte asaj pluhurin e shqetësimit nga fytyra në ato rrethana, kur Hadixheja vdiq, Ebu Talibi vdiq dhe Profeti mbeti i vetëm, pa askënd që ta mbështeste, ndërkohë që të gjithë i drejtoheshin atij? As Hatixhja, as Ebu Talibi nuk ishin më. Në ato kushte të vështira, mes urisë, etjes, të ftohtit dhe vapës, që zgjatën tre vjet në Shu'betu Ebi Talib, një

-
- Kur Allahu mori Profetin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), një trishtim aq i madh hyri në zemrën e Fatimes, sa vetëm Allahu e dinte madhësinë e tij. Kështu Allahu i dërgoi një engjëll ta ngushëllonte dhe të fliste me të. Ajo ia tregoi këtë Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).
 - Kur ta ndiesh dhe ta dëgjosh zërin, më thuaj mua, - i tha Aliu Fatimes.

Kur ajo e njoftoi, Aliu filloi të shkruante çdo gjë që dëgjonte, derisa e mblodhi në një Mus'haf".

- Në të nuk ka asgjë prej hallallit apo haramit, por ka dijen e asaj që do të ndodhë, përfundoi fjalën Imam Sadiku. ("Usulul Kafi", vëll. 1, f. 240, Hadithi 2.)

periudhë ndër më të vështirat në jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), një grup myslimanësh jetonte në një të çarë mali, në një formë internimi të detyruar. Në ato rrethana, kjo vajzë duroi sfidat, ishte si shpëtim për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), “nëna e babait të saj”, dhe një infermiere e jashtëzakonshme për atë njeri të madh.

Ajo e ngushëllonte Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duronte mundimet, adhuronte Allahun, forconte imanin e saj, edukonte veten dhe e hapte zemrën për njohuri dhe dritë hyjnore. Këto janë cilësitë që e çojnë njeriun drejt përsosmërisë.

Pas Hixhretit, në fillimet e moshës së detyrimit fetar, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) u martua me Ali ibn ebu Talibin (*Paqja qoftë mbi të!*). Me siguri e dini thjeshtësinë dhe varfërinë që përjetoi pas martesës, ndonëse ishte bija e personit më të rëndësishëm në botën islame dhe udhëheqësi i asaj shoqërie.

Adhurimi i saj³⁹

Adhurimi i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një model i përsosur i adhurimit. Hasan Basriu, një nga adhuruesit dhe asketët më të njohur në botën islame, thotë për Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*) se bija e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e adhuronte Allahun dhe qëndronte në mihrabin e adhurimit, derisa i ënjteshin këmbët.

Imam Hasan El Muxhteba (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se në një nga netët, nëna e tij qëndroi duke adhuruar Allahun deri në mëngjes, derisa u shfaq shtylla e agimit. Imam Hasani, gjithashtu, thotë se e dëgjonte vazhdimisht duke bërë dua për besimtarët dhe besimtare, për njerëzit, dhe për problemet e përgjithshme të botës islame. Në mëngjes ai i tha: “O nënë, pse nuk lutesh edhe për veten tënde, ashtu siç lutesh për të tjerët?” Ajo u përgjigj: “O biri im, më parë fqinji, pastaj shtëpia”.⁴⁰

39 Nga një fjalë e Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (Paqja qoftë mbi të!), 1419 hixhri.

40 Hysen ibn Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka transmetuar nga vëllai i tij, Hasani (Paqja qoftë mbi të!): “E pashë nënën time, Fatimen, një natë të premte duke qëndruar në mihrabin e saj të adhurimit. Ajo nuk pushoi nga rukuja dhe sexhdet, deri sa erdhi agimi. E dëgjoja duke bërë dua për besimtarët dhe duke i përmendur ata me emra, duke u lutur shumë për ta, ndërsa për veten e saj nuk lutej fare. I thashë: ‘O nëna ime, pse nuk lutesh për veten tënde, ashtu siç lutesh për të tjerët?’ Ajo tha: ‘O biri im, më parë fqinji, pastaj shtëpia’”. (“Biharul Enuar”, vëll. 86, f. 313).

Xhihadi i saj⁴¹

Xhihadi i saj në fusha të ndryshme ishte një xhihad shembullor: në mbrojtje të Islamit, në mbrojtje të imametit dhe velajetit, në mbrojtje të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe në jetesën e saj pranë njërit prej udhëheqësve më të mëdhenj të Islamit, Emirit të besimtarëve, që ishte bashkëshorti i saj.

Imam Aliu ka thënë për Fatime Zehranë: “Ajo kurrë nuk më ka zemëruar dhe asnjëherë nuk ka dalë kundër urdhrit tim”.⁴²

Me gjithë atë madhështi dhe pozitë, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një bashkëshorte e devotshme në shtëpinë e saj, një grua sipas modelit që përcakton Islami, dhe një dijetare e lartë në rrethin e dijes.

Për sa i përket hytbes që Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) mbajti në xhaminë e Medinës pas ndarjes nga jeta të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dijetari i madh, eruditi Mexhlisi, ka thënë: “U takon oratorëve, dijetarëve dhe mjeshtërve të gjuhës që të ulen e të

41 Nga një fjalë e Imam Khameneit, me rastin e lindjes së Zonjës së grave të botëve (*Paqja qoftë mbi të!*), 1419 hixhri.

42 Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Pasha Allahun, unë kurrë nuk e kam zemëruar atë (Fatimen) dhe as e kam detyruar ndonjëherë të bëjë diçka, deri sa Allahu e mori pranë vetes. As ajo nuk më ka zemëruar mua ndonjëherë dhe as nuk më ka kundërshtuar. Vetëm sa e shikoja atë, më zhdukeshin brengat dhe pikëllimet”. (“Keshful Gummeh”, i Ibn Ebil Fet’h El Irbili, vëll. 1, f. 373.)

shpjegojnë fjalët dhe shprehjet e kësaj hytbeje, ngaqë ajo ka një vlerë të jashtëzakonshme”.

Për nga bukuria artistike, ajo ishte si më të bukurat dhe më të lartat prej fjalëve të “*Nehxhul Belagës*”, në nivelin e fjalës së vetë Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*). Fatime Zehraja shkoi në xhaminë e Medinës, qëndroi përpara njerëzve dhe foli spontanisht për rreth një orë, me fjalët më të bukura dhe me kuptimet më të pastra.

Pozita shpirtërore e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*)

Mirësitë shpirtërore të Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u kufizuan vetëm te një grup i vogël njerëzish, i llogaritur si një numër i caktuar përballë gjithë njerëzimit. Kjo “**mirësi e shumtë**”, që Allahu i Madhëruar i dha Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në suren e bekuar “*Keuther*”: “**Ne të dhamë ty Keutherin**”, dhe Fatime Zehraja (a.s), është një burim i të gjitha mirësive që do të derdhen, ditë pas dite, nga burimi i fesë profetike drejt gjithë njerëzimit dhe gjithë krijesave.

Shumë u përpoqën ta fshihnin dhe ta mohonin, por nuk ia dolën, sepse: “**Allahu do ta përmbushë dritën e Tij, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë**”.

Duhet të afrohemi te kjo qendër drite dhe afërsia e vërtetë ka një rezultat të domosdoshëm: ndriçimin.

Duhet të bëhemi të ndriçuar, jo me dashuri të zbrazët, por me veprim – veprim që na e kërkon kjo dashuri, kjo mbështetje dhe ky besim. Me këtë veprim, duhet të bëhemi pjesë e kësaj familjeje të bekuar dhe të lidhur me të.

Nuk është aspak e lehtë që njeriu të bëhet Kamberi në shtëpinë e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Nuk është e lehtë që njeriu të arrijë shkallën e Selman Farisijut, për të cilin Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Selmani prej nesh, Ehli Bejt*”.

Shikoni këtë zonjë madhështore: në ç’moshë mori ajo të gjitha këto virtyte? Në ç’moshë u shfaqën te ajo këto shkëlqime? Në një jetë kaq të shkurtër, 18, 20 ose 25 vjet sipas transmetimeve, ajo arriti gjithçka. Këto virtyte nuk vijnë rastësisht.

Allahu e sprovoi Zehranë e pastër, atë që ishte e zgjedhura e Tij. Sistemi hyjnor është një sistem me llogari të saktë. Çfarë Ai jep, është i llogaritur me hollësi. Ai e përgatiti këtë nivel të jashtëzakonshëm sakrifice, dijeje dhe përkushtimi (që është cilësi e të zgjedhurve të Tij) për hir të objektivave hyjnore; prandaj e bëri atë qendër të rrjedhjes së Tij shpirtërore.

Na transmetohet se shkëlqimi i dritës së Fatimes (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte aq i madh, saqë verbëronte engjëjt më të afërt të qiellit të lartë, “drita e saj shndriti për engjëjt e qiellit”. Po ne, çfarë përfitojmë nga kjo dritë dhe shkëlqim?

Duhet të udhëhiqemi nga ky yll i ndritshëm drejt Allahut dhe drejt rrugës së adhurimit, rruga e drejtë, të cilën Fatime Zehraja e ndoqi deri në shkallët më të larta shpirtërore. Allahu e krijoi prej një dheu të lartë, sepse e dinte se Fatimja do të dilte me kokë lart nga sprova e botës materiale:

Për sa i përket pozitës shpirtërore të kësaj zonje madhështore, krahasuar me pozitën e saj xhihadiste, revolucionare dhe shoqërore, ajo është shumë më e lartë.

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), në dukje, ishte një njeri, një grua e re, por në realitet ajo ishte një e vërtetë e madhe, një dritë hyjnore, një e zgjedhur, një genie unike.

Ajo, kur qëndronte në mihrabin e adhurimit, mijëra engjëj të afërt i drejtoheshin, e përshëndesnin dhe e uronin, duke i thënë ashtu siç i thanë dikur Merjemes së pastër (*Paqja qoftë mbi të!*): “O Fatime, Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka zgjedhur mbi gratë e botëve”.

Kjo është pozita shpirtërore e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Për të, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*): “O Ali, ti je imami i umetit tim dhe pas meje zëvendësi im. Ti je ai që i udhëheq besimtarët drejt Xhenetit. Unë po e shoh vajzën time, Fatimen, Ditën e Kiametit duke ardhur mbi një deve drite, me 70 000 engjëj në të djathtën e saj, 70 000 në të

majtën, 70 000 para saj e 70 000 pas saj, duke udhëhequr gratë besimtare të umetit tim drejt Xhenetit”.

Pra, në Ditën e Kiametit, Aliu do të udhëheqë burrat besimtarë, kurse Fatime Zehraja do të udhëheqë gratë besimtare drejt parajsës hyjnore. Ajo është me Aliun, në pozitë dhe madhështi.

Udhëheqëse, në kuptimin e plotë të fjalës

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka ushtruar rolin e një udhëheqëseje të vërtetë. Ashtu siç ka thënë Imami ynë i madhërueshëm, Khomeini: “Sikur Fatime Zehraja të ishte burrë, ajo do të ishte profet”. Kjo është një fjalë e jashtëzakonshme dhe jashtëzakonisht madhështore, dhe nuk mund të thuhet veçse nga dikush si Imam Khomeini, i cili ishte dijetar, jurist dhe, mbi të gjitha, njohës i thellë i dimensioneve shpirtërore.

Kjo është Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo është udhëheqëse, në çdo kuptim të fjalës, si një i dërguar nga të dërguarit, si një udhëzuese për gjithë njerëzimin.

Kjo vajzë e re, kjo e pastër e ndritur, u shfaq me këtë madhësi, me këto me këtë përmasë të jashtëzakonshme.⁴³

⁴³ Imam Khamenei, 19.3.2017.

Jeta e Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) është një mësim për njerëzimin⁴⁴

Pozitat shpirtërore të zonjës Fatime Zahra (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) renditen ndër nivelet më të larta shpirtërore që i janë dhënë vetëm një numri shumë të vogël njerëzish. Ajo është e pagabueshme dhe pagabueshmëria është një cilësi që u jepet vetëm pak prej miqve hyjnorë mes bijve të Ademit.

Kjo grua madhështore, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), është një prej tyre. Sidomos kur marrim parasysh faktin se kjo grua myslimane, luftëtare në rrugën e Allahut, nuk jetoi më shumë se rreth njëzet vjet, sipas transmetimeve midis tetëmbëdhjetë dhe njëzet e pesë vjet. Ajo ishte një grua e re që arriti këtë gradë të lartë, krahasuar me të dërguarit, miqtë e shquar të Allahut dhe njerëzit e zgjedhur. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e quan “Zonja e grave të botëve”.

Përveç kësaj pozite shpirtërore, cilësitë e saj të jashtëzakonshme dhe sjellja e saj e përkryer në jetën personale përbëjnë, në çdo hap, një mësim. Devotshmëria e saj, pastërtia e saj, përpjekja e saj në rrugën e Allahut, sjellja e saj shembullore bashkëshortore, edukimi i fëmijëve,

⁴⁴Imam Khamenei, 19.4.2014.

kuptimi i saj politik dhe pjesëmarrja në fushat më të rëndësishme të jetës së njeriut në atë kohë, qoftë në periudhën e fëmijërisë dhe rinisë, apo pas martesës, çdo gjë në jetën e saj ishte një mësim.

Ky nuk është një mësim vetëm për gratë, por për gjithë njerëzimin. Prandaj, ky përafrim është një mundësi për ne. Duhet ta studiojmë me vëmendje jetën e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), ta njohim atë me një këndvështrim të ri, ta kuptojmë dhe ta marrim si model dhe shembull në kuptimin e plotë të fjalës.

Personaliteti gjithëpërfshirës i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), shembull për gruan myslimane⁴⁵

Xhihadi i asaj zonje madhështore në fusha të ndryshme ishte një xhihad shembullor: në mbrojtje të Islamit, në mbrojtje të imametit dhe velajetit, në mbrojtje të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si edhe në jetesën e saj me njërin prej udhëheqësve më të mëdhenj të Islamit, Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun, i cili ishte bashkëshorti i saj.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë një herë për Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*):

⁴⁵ Imam Khamenei, 16 dhjetor 1992.

“Ajo kurrë nuk më ka zemëruar dhe asnjëherë nuk ka dalë kundër urdhrit tim”.

Me gjithë madhështinë dhe pozitën e saj, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një bashkëshorte e devotshme në shtëpinë e saj, një grua sipas modelit që përcakton Islami dhe një dijetare e lartë në fushën shkencore e shpirtërore.

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) shkoi në xhaminë e Medinës, qëndroi përpara njerëzve dhe foli spontanisht për rreth një orë të plotë, me fjalët më të bukura, me kuptimet më të pastra dhe më të thella.

I tillë ishte adhurimi i saj, elokuenca e saj, urtësia e saj, dituria e saj, xhihadi i saj, sjellja e saj si bashkëshorte dhe si nënë, si edhe bamirësia e saj ndaj të varfërve.

Një herë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgoi një burrë të moshuar e të varfër në shtëpinë e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha t’u kërkonte atyre për nevojën e tij. Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha atij lëkurën mbi të cilën flinin Hasani dhe Hyseni, sepse ajo nuk kishte asgjë tjetër përveç kësaj. Ajo i tha: “Merre, shite dhe përfito nga paratë e saj”.

Ky është personaliteti gjithëpërfshirës i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo është një model i përsosur për gruan myslimane.

Drita e Fatime Zehrasë i mahnit engjëjt⁴⁶

Kjo yllnajë e shndritshme në botën e ekzistencës nuk është thjesht ajo që shohin sytë tanë. Zonja Fatime Zehra (*Paqja qoftë mbi të!*) është shumë më e lartë se çdo përshkrim që mund të japim. Ne shohim vetëm shkëlqimin e dritës së saj, por realiteti i saj është shumë më i madh, sesa fjalët që mund të themi.

Por çfarë marrim unë dhe ju nga kjo? A mjafton thjesht të dimë se ajo është Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Kam lexuar në një transmetim se shkëlqimi i dritës së Fatime Zehrasë mahnit shikimet e engjëjve të afërt të qiellit: *“Drita e saj ndriçoi engjëjt e qiellit”*.⁴⁷ Ajo u shfaqet atyre duke rrezatuar dritë.

Po ne, çfarë përfitojmë nga ky rrezatim dhe kjo dritë e madhe? Përmes këtij ylli që shkëlqen, duhet të gjejmë rrugën drejt Allahut, rrugën e të vërtetës, të cilën Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) e përshkoi dhe arriti në ato grada të larta.

Nëse e shihni që Allahu e krijoi brumin e saj prej një brumi të lartë dhe të përzgjedhur, kjo është sepse Ai e dinte

⁴⁶ Imam Khamenei, 24 nëntor 1994.

⁴⁷ Fragment nga hadithi profetik. “El Emalij”, i Shejkh Sadukut, Tubimi 24, f. 99.

që krijesa e Tij do të dilte fitimtare në mënyrë të përsosur nga sprovat e botës materiale dhe njerëzore: “Allahu të sprovai para se të të krijonte dhe të gjeti të duruar”.⁴⁸

Ka shumë njerëz që kanë brumë të mirë në krijim, por a i kaluan të gjithë provat? Jo. Kjo është një pjesë nga jeta e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe është ajo që na duhet për shpëtimin tonë.

⁴⁸ Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), “Tehdhijb”, vëll. 6, f. 10.

PËRMBAJTJA

SIKUR BUKURIA TË ISHTE NJË PERSON, AJO DO TË ISHTE FATIMJA	5
Ja si e përshkruante Imam Aliu Fatime Zehranë (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>)	8
Jeta e Fatimes (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) në adhurim	10
Nuk ka shpirtmirësi më të lartë se ajo e Fatime Zehrasë	
Personaliteti gjithëpërfshirës i Fatime Zehrasë (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)	11
FJALA E BOTUESIT	14
Fatime Zehraja (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), gruaja që mishëron nderin dhe besimin	14
Fatimja, gruaja që mishëron nderin dhe besimin	18
Fatimja, shkëlqimi i dritës që zbret nga qielli	19
Fatimeja, modeli i pastërtisë hyjnore	20
Kur Fatimja hynte në dhomë, drita e saj errësonte dritën e yjeve	20
Fatimeja, nderi i gruas myslimane	21
Fatimja, zëri i së vërtetës	22
Dashuria e Profetit Muhamed (a.s) për të	22
Fatime Zahraja (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) në fjalët e Imam Ali Khameneit	25

Fatimja, mrekullia e Islamit	25
Arritja e gradës së “Sidikëve” nëpërmjet adhurimit	26
Gjuha është e paaftë të shpjegojë madhështinë e saj	28
Madhështia e saj	30
Shembulli më i qartë i “Keutherit”	33
Nuk është e mundur të perceptohen rangjet e saj shpirtërore	36
Jeta e saj bashkëshortore.....	37
Një qiell i lartë që përmbante në gjirin e tij yjet e shndritshëm të vilajetit	39
Pozita e saj	40
Njohja jonë për të dhe lidhja jonë me të	42
Çështja e parë: Sa e njohim ne Zehranë (Paqja qoftë mbi të!)?	42
Çështja e dytë: Ne duhet ta gjejmë rrugën përmes yjeve	43
Përqendrimi te përmbajtjet edukative fatimiane	44
Udhëzimi nga drita e Zehrasë (Paqja qoftë mbi të!).....	44
Virtytet dhe meritat shpirtërore	45
Adhurimi i saj	48
Xhihadi i saj	49
Pozita shpirtërore e Fatime Zehrasë (Paqja qoftë mbi të!) 50	
Udhëheqëse, në kuptimin e plotë të fjalës	53

Jeta e Zehrasë (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) është një mësim për njerëzimin	54
Personaliteti gjithëpërfshirës i Fatime Zehrasë (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), shembull për gruan myslimane	55
Drita e Fatime Zehrasë i mahnit engjëjt	57

فاطمة الزهراء (عليها السلام)
في كلمات الإمام الخامنئي (دام ظله)

تيرانا 2025

اسم الكتاب: فاطمة الزهراء (عليها السلام) في كلمات الإمام الخامنه (دام ظله

المترجم: إسراء مزيّا

التصحیح الأدبي: بریدا کولا

التصحیح اللغوی: الحاج ولنت مریّا

الخراج النهائي و تصمیم الغلاف: صبریه فزا

ناشر: جمعية النسم - تیرانا - ألبانیا